

Informacione në lidhje me rregulloret aktuale të urdhëresës për mbrojtjen nga infeksionet e reja nga koronavirusi SARS-CoV-2 për sa i përket udhëtarëve që hyjnë dhe që kthehen (Urdhëresa e hyrjes për koronavirusin – CoronaEinrVO) që nga 21 Qershori 2020, në versionin që vlen duke filluar që nga 22 Qershori 2020.

Për cilët udhëtarë vlen detyrimi për të qëndruar në karantinë në shtëpi kur hyjnë?

Qeveria federale dhe republikat kanë rënë dakord, që njerëzit të cilët hyjnë në vend nga zonat e rrezikshme duhet të qëndrojnë kryesisht 14 ditë në karantinë në shtëpi.

Cilat republika konsiderohen zona të rrezikshme?

Zonat e rrezikshme caktohen nga qeveria federale dhe publikohen nga Instituti Robert Koch (RKI). Kjo përfshin edhe numrin e rasteve edhe një vlerësim të evenimenteve respektive të testimit dhe të infeksionit. Ju mund ta gjeni një pasqyrë të zonave aktuale të rrezikshme online tek RKI:

https://www.rki.de/DE/Content/InfAZ/N/Neuartiges_Coronavirus/Risikogebiete_neu.html

Cilët persona konsiderohen të përjashtuar nga rregulli i karantinës?

Përjashtimet nga karantina vlejné për grupe të caktuara njerëzish, për shembull nëse ka arsye detyruese biznesi për udhëtimin. Mund të përjashtohesh gjithashtu nga karantina, duke treguar një test negativ të koronavirusit në hyrje, i cili nuk është më i vjetër se 48 orë. Për më tepër, nuk vlen më rregullorja për personat të cilët gjenden në tranzit përmes Nordrhein-Westfalen .

Shënim: Shpjegimet e mësipërme nuk janë teksti ligjërish detyrues. Ky gjendet tek versioni i urdhëresës së hyrjes për koronavirusin. Online:

https://www.land.nrw/sites/default/files/asset/document/2020-06-21_fassung_coronaeinrvo_ab_22.06.2020.pdf